



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:109816

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05705919

**NË EMËR TË POPULLIT**

**PKR.nr.250/2006**

**- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari Fatos Sejdiqaj, anëtarët e trupit gjykues-Gjyqtarët: Avni Mehmeti dhe Marigona Lajqi, me bashkëpunëtorin profesional Donjeta Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit: A.I. për shkak të veprës penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 229 par.4 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK), sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.331/2004 dt.06.01.2005. Në këtë çështje penale është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor, seanca ka qenë e hapur për publikun, dhe është mbajtur në prezencën e palëve; Prokurorit të shtetit në PTH-Mitrovicë, Njazi Rexha, të pandehurit A.I. dhe Mbrojtësit Av.Bajram Halimi, sipas detyrës zyrtare. Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më 17.05.2024 të njëjtën ditë është shpallur aktgjykimi, ndërsa më datë 20.05.2024 është përpiluar me shkrim ky :

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri :

**A.I.**, nga babai ..... dhe nëna ....., mbiemri i vajzërisë ....., i lindur me datë ..... në .....-Komuna Rahovec, ku dhe tani jeton, me numër personal ....., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar-baba i gjashtë fëmijëve, i punësuar në subjektin afarist “.....” në Mal të Zi, i gjendjes së mesme ekonomike.

- Në mbështetje të nenit 362 par.1, pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës :

### **REFUZOHET AKUZA**

- **SEPSE** : Duke vepruar si anëtarë grupi së bashku më NN personin, paautorizim kanë poseduar e pastaj kanë shpërndarë e transportuar me qëllim shitjeje drogën, në atë mënyrë që sipas marrëveshjes së tyre paraprake, së pari më datën 13.12.2004, i pandehuri A. në fshatin Poterqan i Epërm, Komuna e Rahovecit, ia ka dhënë drogën e tipit “Heroin” në sasi prej 1,064 gramëve, të pandehurit R. i cili këtë sasi të drogës e ka marrë, e ka vendosur në automjetin e markës “Ford Siera”, me targë ..... dhe me të e ka transportuar gjerë në Mitrovicë me qëllim që këtë sasi të drogës ta shpërndaj për shitje e pastaj me datën 16.12.2004, përmes telefonit mobil ka kontaktuar më një NN person dhe kanë caktuar vendin dhe kohën e takimit për t’ia dorëzuar në shitje këtë sasi të drogës këtij personi por duke shkuar për të vendi i takimit gjatë transportimit në Rr. “Mbretëresha Teuta” në Mitrovicë, është ndalur nga patrulla e policisë dhe gjatë bastisjes kjo sasi e drogës është gjetur dhe sekuestruar, kurse i pandehuri R.. është arrestuar.

- **Me këtë kishte për të kryer veprën penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.4, pika 1 lidhur me par.2 dhe 1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së.**

- Në mbështetje të nenit 229 par.5 të KPPK-së dhe nenit 276 par.1 të KPP-së, URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike-heroinë, në peshë prej 1.064 gram. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, kjo substancë narkotike duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

- Kërkesë pasurore – juridike nuk kishte.

### **A r s y e t i m**

- **Aktakuza –**

- Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën, PP.I.nr.331/2004, të datës 06.01.2005, kundër të pandehurve; R.B. dhe A.I., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së.

- Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka nxjerr aktgjykimin P.nr.4/2005 të datës 30.05.2005, me të cilin të pandehurin A.I. e ka liruar nga akuza për veprën penale- Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 dhe par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së ndërsa, të pandehurin R.B. e ka shpallur fajtor për veprën penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 dhe par.1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së, dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej një mijë (1000) euro.

- Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin Ap.nr.463/2005 të datës 02.05.2006, ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimin P.nr.4/2005 të datës 30.05.2005 e ka anuluar dhe çështja është kthyer në rigjykim.

- Tani ndaj të pandehurit të parë, R.B. është nxjerr aktvendimi P.nr.250/2006 i datës 04.03.2022, me të cilin është pushuar procedura penale pasi është konstatuar se i njëjti ka vdekur me datë 08.01.2019, fakt ky i vërtetuar sipas certifikatës së vdekjes me numër të referencës ....., me numër rendor 4 të lëshuar me datë ..... nga Komuna e Glllogocit- Zyra e Gjendjes Civile Komoran.

#### **- Kompetenca -**

Sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29, paragrafi 1 i KPP-së. Sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo natyrë e veprave penale për të cilën akuzohet i pandehuri, sipas nenit 22 par.1, nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1.2 pika 1.2.66 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) hynë në kompetencë të Departamentit për Krime të Rënda.

#### **- Rrjedha e procedurës -**

- Këtë lëndë penale Kryetari i Trupit Gjykses e ka pranuar me datë 19.01.2024 dhe pas pranimit të lëndës, shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 17.05.2024. Shqyrtimi gjyqësor ka qenë publik, është regjistruar në procesverbal dhe është mbajtur në prezencën e

palëve-Prokurorit të shtetit Njazi Rexha, të pandehurit A.I. dhe Mbrojtësit të tij av.Bajram Halimi, caktuar sipas detyrës zyrtare.

- Në shqyrtimin gjyqësor, prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të pandehurit A.I., për veprën penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, pasi ka vlerësuar se nga provat e administruara dhe dëgjimi i dëshmitarëve A.B., B.G. dhe H.I. të njëjtit nuk kanë dëshmuar se kanë njohuri sa i përket substancës narkotike, e gjithashtu edhe nga kontrollimi i shtëpisë së të pandehurit A.I. nga Policia nuk është gjetur asgjë e kundërligjshme. Për më tepër kemi vetëm deklaratën e tani të ndjerit të bashkakuzuarit R.B. i cili e ka ngarkuar të pandehurin, nga ku i akuzuari nuk mund të shpallet fajtor vetëm mbi një provë, andaj në mungesë të provave është tërhequr nga aktakuza.

#### **- Gjetjet e gjykatës -**

- Gjykata, pasi që Prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të pandehurit A.I., për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.4 pika 1 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, vlerëson se prokuroria ka të drejtë ligjore në çdo kohë të tërhiqet nga ndjekja penale, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Bazuar në këto arsye, trupi gjykues pranë kësaj gjykate vlerëson se në mungesë të aktakuzës nuk mund të vazhdoj shqyrtimin gjyqësor. Mbi këtë bazë, Gjykata ka konstatuar se në tërësi janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës dhe nxjerrjen e aktgjykimit refuzues në mbështetje të nenit 362 par.1, nënpar 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

- Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 229 par.5 të KPPK-së dhe nenit 276 par.1 të KPP-së, ndaj të pandehurit A.I. vendosi dhe urdhëroi konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike heroinë në peshë prej 1.064 gram, e cila duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Gjykata e ka liruar të pandehurin A.I., nga shpenzimet e procedurës penale, pasi që Gjykata ka vendos ta refuzoj akuzën ndaj tij, kjo në bazë të dispozitës së nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga ajo që u tha me lart u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti për Krime të Rënda**

**PKR.nr.250/2006, datë 20.05.2024.**

**Zyrtari ligjor**

**Bardh Sylejmani**

**Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari**

**Fatos Sejdijaj**

---

**- KËSHILLË JURIDIKE :** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.